Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 334/01
Datë: 29.06.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 02.06.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

Akreditohet dhe validohet **Qendra e Bukurisë "KAS"** në Ferizaj me adresë Rr."Vëllezërit Gervalla", afër market Guri, pn, 70000 dhe Kamenicë me adresë Rexhepaj Center, për periudhën 02.06.2017 deri 02.06.2020 për të ofruar kualifikime të validuara në KKK:

1.1. Parukeri; Niveli III sipas KKK, me 120 kredi të AAP.

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

2.1 Hartim i politikave për zhvillim profesional të stafit mesimdhënës/trajnerëve në aspektin metodik dhe didaktik si dhe çertifikimi i tyre.
2.2 Të krijohet dalja emergjente (në qendren në Ferizaj).
2.3 Kodi i mirësjelljes të vendoset në vend të përshtatshëm (në të dy qendrat Ferizaj dhe Kamenicë).
2.4 Të vendoset kutia e ndihmës së parë (në qendrën e Kamenicës).
2.5 Kursi i Parukerisë duhet të filloj në grup dhe njëkohësisht.
2.6 Të përcaktohet shkalla e vlerësimit të kandidatëve gjatë trajnimit dhe në testimin përfundimtar të jetë i shoqëruar me pikët kualifikuese.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën 31.10.2017, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:
Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:
   - KAS;
   - AKK.

Bedri Xhafa

Kryetari i KD së AKK-së